KOHA JONE 6
E enjte, 10 KORRIK 2014

Lançohet marrëveshja e kredisë në shumën prej 6 milionë eurosh me Bankën e Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim

# Fondi "Besa", mbështetje bizneseve mikro dhe SME-ve




Mbështetje dhe financim bizneseve mikro dhe të ashtuquajturave SME (ndërmarrje të vogla dhe të mesme). Kjo është ajo që qëndron në thelb të një marrëveshjeje kredie në shumën prej 6 milionë eurosh me Bankën e Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim dhe Fondit "Besa", nënshkrimi i së cilës u lançua ditën e djeshme gjatë një aktiviteti të posaçëm, në prani edhe të përfaqësuesve të institucioneve financiare në Shqipëri.

**QËLLIMET**

### Pse do përdoret kredia?

- Financimi i projekteve të veçanta ose programeve të investimeve për krijimin, modernizimin dhe diversifikimin e projekteve në industri, bujqësi dhe prodhim, si dhe në sektorin e shërbimeve.

- Si kapital qarkullues për bizneset në industri, bujqësi si dhe bizneset e përpunimit, prodhimit dhe shërbimeve e nevojave për financim për kapital qarkullues të projekteve apo investimeve të caktuara.

- Financimin e bizneseve në sektorin e industrisë dhe bujqësisë, të orientuara kryesisht drejt eksportit.

**PROFIL**

Fondi "Besa" është një ndër institucionet më të mëdha mikrofinanciare dhe lider në Shqipëri, i cili u ofron individëve kredi mikro, të vogla dhe të mesme për të hapur, zgjeruar dhe zhvilluar aktivitete fitimprurëse. Me dhjetëra zyra në gjithë Shqipërinë, ai synon të jetë i pranishëm atje ku ka nevojë për zhvillim, duke u ofruar akses mijëra njerëzve dhe duke u përpjekur t'i mbështesë ata me shërbime financiare, duke krijuar lidhje ndërmjet klientëve dhe mundësive e duke kontribuar kështu në një zhvillim më të madh ekonomik të vendit.



Nga ana e tij, Drejtori Ekzekutiv i Fondit "Besa" z. Bajram Muça, e ka cilësuar si një moment të rëndësishëm këtë event, pikërisht inicimin e një bashkëpunimi me Bankën e Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim. Kurse zv/presidenti i kësaj banke, Mustafa Boran, i pranishëm gjatë tij, është shprehur se "ne jemi të gatshëm dhe kemi dëshirën e mirë që të mbështesim iniciativat për biznes, për sa kohë ato janë të realizueshme". Pasuar edhe nga një konfirmim i bërë prej ministrit të Bujqësisë, Edmond Panariti me këtë rast, se dikasteri që ai drejton "do të mbetet i hapur për të mbështetur në iniciativa të reja të tilla". Të cilat sipas tij, i japin një shtysë të re bujqësisë dhe agrobiznesit shqiptar. Po cilat janë në vetvete qëllimet për të cilat do të përdoret kjo kredi në financimin e bizneseve mikro dhe SME? Së pari, bëhet fjalë për financimin e projekteve të veçanta ose programeve të investimeve për krijimin, modernizimin dhe diversifikimin e projekteve në industri, bujqësi dhe prodhim, si edhe në sektorin e shërbimeve. Sikundër, edhe për kapital qarkullues për bizneset në industri, bujqësi si dhe bizneset e përpunimit, prodhimit dhe shërbimeve e nevojave për financim për kapital qarkullues të projekteve apo investimeve të caktuara. Pa harruar as qëllimin e financimit të bizneseve në sektorin e industrisë dhe bujqësisë, të orientuara kryesisht drejt eksportit. Teksa drejtuesit e Fondit "Besa" vlerësojnë nga ana e tyre se realizimi me sukses i kësaj marrëveshje kredie mes tyre dhe Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim, përbën në vetvete një mbështetje dhe vazhdim i misionit të këtij institucioni për të kontribuar në rritjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisë së vendit në zonat urbane dhe gjysmë-urbane, e pikërisht nëpërmjet financimit të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në Shqipëri.
Sikundër shtojnë edhe faktin se ajo është pjesë e strategjisë së saj në kuadrin e diversifikimit të burimeve të plotësimit të nevojave për fonde dhe realizmit të objektivave ambicioze të rritjes dhe konsolidimit të aktivitetit, si edhe të ndërtimit të një partneriteti afat-gjatë të Fondit "Besa" me donatorë dhe institucione financiare serioze. Teksa vetë Drejtori Ekzekutiv, Bajram Muça pohon se ky fond është i vendosur ta rrisë më tej aktivitetin e tij, në ndihmë të zhvillimit të zonave pazhvilluara, rritjes së punësimit dhe rritjes ekonomike të vendit.

**STATISTIKA**

Deri në fund të vitit 2013, Fondi "Besa" ka shënuar rreth 27.000 klientë aktive dhe një tepricë kredie prej rreth 5.4 miliardë lekësh dhe ka dhënë që nga fillimi i aktivitetit rreth 115.000 kredi në vlerë rreth 40 miliardë lekësh.



